



## KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

### Procesverbal i mbajtur më 06 prill 2021, në mbledhjen e XXXV-të (tridhjetë e pesë) mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, kati përdhes, dhe filloi në orën 10:05

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Arlinda Kadriu, Fatlume Jaha, Adelinë Stublla, Florent Hasani, Rafet Llapashtica, Endritë Murati, Patriot Rudari,

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin; Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, Bahri Selimi, drejtor i Drejtorisë së Administratës-DA, Elhame Kutllovci, drejtoresh e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit – DKRS, Fatlum Osmani, drejtor i drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Bahrije Shatrolli-Mehmeti, drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë – DPKGJ.

#### Rendi i ditës

**z.Fatmir Gashi**, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i falënderuar dhe përshëndetur të pranishmit, ndër të tjera shtoi, nëse ka dikush diçka për të shtuar urdhëroni, nëse nuk ka diçka për të shtuar e vë në votim rendin e ditës.

*Njëzëri u miratua rendi i ditës.*

#### 1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 09 mars 2021

*Njëzëri u miratua procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 09 mars 2021.*

#### 2. Raporti Financiar për vitin 2020

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, paraqiti raportin financiar për vitin 2020, ndër të tjera theksoi, si Drejtori jemi përpjekur të bëjmë maksimumin që ky raport të jetë efikas, transparent dhe i kuptueshëm për të gjithë, për çka deri në një masë kemi arritur objektivat, ky raport është proceduar për prezantim në mbledhjen e Kuvendi të Komunës, natyrisht përmes këtij Komiteti, besoj se materiali ju është përcjellë me kohë të gjithë asamblistëve andaj nëse ka pyetje ne jemi të hapur që t'ju japim sqarime shtesë qoftë verbalisht qoftë në formë të shkruar përmes email adresave.

**z.Mehmet Gashi** theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së këtë raport financiar e rekomandon për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit. Kam një sugjerim, kur thuhet se raporti financiar është në pajtim me ligjin, duhet pasuar parasysh që sipas ligjit për financat publike afati i fundit për raportim në Kuvend është deri më datë 31 mars, prandaj është mirë t'i përmbaheni ligjit.

Sa i përket të hyrave vetanake nuk vërejtja bartjen e tyre që ka qenë në plan të Kuvendit të Komunës, andaj të merren parasysh edhe ato pika, kurse sa i përket materialit ne nuk kemi vërejtje.

**z.Florent Hasani**, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së i rekomandon Kuvendit për shqyrtim këtë raport financiar për vitin 2020.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, edhe Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së i rekomandon Kuvendit për shqyrtim raportin financiar për vitin 2020.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, theksoi, sa i përket çështjeve të ngritura, ne kemi menduar se kjo seancë do të mbahet në fund të muajit mars dhe rrjedhimisht kjo seancë është shtyrë për muajin prill, ndoshta edhe mund të jetë një tejkalim ligjor i paraqitjes së këtij raporti.

Sa i përket çështjes së të hyrave vetanake nga viti 2020 në vitin 2021, arsyeja pse është shtyrë kjo ka qenë çështja te Ministria e Financave që nuk e kanë bartë barazimin në kohë, ne kemi mundur me përcjellë sot por nuk e kemi parë të rrugës që një pikë e cila është shumë të rëndësishme të mos kalojë përmes procedurës së rregullt dhe mos të përcillet materiali me kohë. Përndryshe ne kemi qenë të gatshëm që në ditën e premtë ta përcjellim materialin sepse ditën e enjte Ministria e Financave e ka bërë barazimin për Komunën e Podujevës. Rrjedhimisht nuk ka qenë i ditur barazimi i saktë sepse edhe një cent kur të llogaritet është shumë i rëndësishëm dhe për mos llogaritje të saktë mund të na kthehet prapa vendimi në asamblenë Komunale. Prandaj materialin për bartjen e të hyrave vetanake ne kemi dashur që ta procedojmë sipas procedurave të rregullta, e jo në mënyrë urgjente.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, përherë i përcjellë me kohë temat që janë të parapara dhe të miratuara në Kuvend, materialet që vijnë unë i procedoj me kohë, nëse dikush ka për të shtuar diçka urdhëroni, sa për njoftim prezentë është edhe anëtarja e KPF-së znj.Adelina Stublla, konfirmoj se përbërja e anëtarëve të KPF-së është e kompletuar dhe mund të vazhdojmë me punë andaj e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet për shqyrtim Kuvendit.

*Njëzëri i rekomandohet për shqyrtim të raportit financiar për vitin 2020 .*

### **3. Propozim vendimi për vënie në diskutim publik të propozim Rregullore për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës**

**z.Bahri Selimi**, drejtor DA, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike, ndër të tjera theksoi, siç jeni në dijeni më datë 09.09.2020 kjo rregullore ka dalë në Kuvend dhe ka marrë pëlqimin për me dalë në diskutim publik, por për shkak të masave të marra për parandalimin dhe luftimin e virusit covid-19, është marrë vendim që kjo rregullore të shtyhet për një kohë të pacaktuar. Ne kemi menduar se tani ka ardhë një moment që kjo rregullore ta marrë prapë pëlqimin e Kuvendit që të dalë në diskutim publik, dhe ashtu siç jeni në dijeni tani është marrë një vendim nga Qeveria e Republikës së Kosovës për masa të reja që fillojnë nga nesër deri më datë 18.04.2021.

Kjo rregullore do të ishte mirë që të dalë në diskutim nga data 19.04.2021, dhe të ketë kohë të debatit publik dy muaj apo 60 ditë, ndërsa sa i përket caktimit të datave mendoj se prapë nuk do të jemi të gatshëm të caktojmë data të mbajtjes së mbledhjeve sepse nuk e dimë se si do të rrjedhë situata në vazhdim bazuar gjithëherë në kushtet dhe rrethanat si dhe masat e reja për parandalimin dhe luftimin e

virusit covid-19. Kërkesë e imja është që Kuvendi t'i japë një lloj autorizimi Drejtorisë së Administratës për caktimin e datave të debateve publike brenda periudhës së diskutimit publik, nëse jeni dakord mendoj se do të ishte mirë që Drejtoria gjithëherë komfor rregullave të IKSHPK-së, të caktojë datat dhe të bëjë njoftim publik gjatë kësaj periudhe 60 ditore prej datës 19.04.2021, pas përfundimit të këtyre masave të përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Sa i përket vendeve se ku do të mbahen debatet publike, si propozim i imi është të jenë: fshati Kërpimëh që është një qendër e fshatrave më verior të Komunës së Podujevës, fshati Ballavë me rrethinë, fshati Lluzhan me rrethinë si dhe në qytet në tri lokalitete të mbahen diskutimet publike, propozim ky i cili mendoj se do të ishte mirë të merret parasysh, mirëpo pres sugjerimet e juaja që vlejnjë të theksohen, atëherë diskutojmë së bashku edhe në mbledhjen e Kuvendit.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, sqarimet u dhanë, mirëpo ne gjithëherë duhet t'i kemi parasysh vendimet e IKSHPK-së, dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

**znj.Fatlume Jaha**, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e mirëpresim sjelljen e një pike të rendit të ditës duke marrë parasysh kronologjinë ashtu siç e paraqiti drejtori i Drejtorisë së Administratës që kjo pikë ka qenë edhe më herët e propozuar në Kuvend. Për hir të së vërtetës më vjen mirë që se harrove kohën më të përshtatshme të mundur për shkak të rrethanave, sido që të jetë unë mendoj se ruajtja e shëndetit duhet të jetë mbi të gjitha, realisht ne duhet të mendojmë konkretisht dhe shumë qartë se si do të mbahen diskutimet publike pastaj të merret një vendim sepse nuk e di se sa është i ngutshëm apo është me patjetër që të bëhet tani, por ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së, këtë pikë të rendit të ditës i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim, mirëpo ndajmë shqetësimet e njëjta ashtu siç i ceku drejtori për shkak të rrethanave shëndetësore që gjendemi si vend.

**z.Florent Hasani**, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së, i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, sa i përket pikës së rendit të ditës është e vërtetë që kjo pikë e rendit të ditës është shtyrë skajshmërisht dhe është dashur të jenë funksionalizuar këshillat e fshatrave gjatë vitit 2020, mirëpo nuk ka pas disponim. Unë mendoj se duhet të formohen këto këshilla por të merren parasysh organizimi i debateve pasi që të hyjnë në funksion të zbatimit masat e marra nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Në bazë të propozim vendimit të sjellë nga Kryetari shihet që kanë me qenë 20 këshilla të fshatrave si dhe këshillat e qytetit që janë ndarë në bazë të hartës së paraparë. Nëse i zbatojmë këto masa tubimet publike s'mund të mbahen për arsye se numri i pjesëmarrësve në tubime qoftë edhe për dasma është deri në 10 persona sipas vendimit të Qeverisë, kështu që unë mendoj se nëse ne i zbatojmë masa tubimet publike nuk mund të mbahen. Ato lokalitete ku drejtori i ka paraparë që të mbahen tubime publike me qytetarë e që përfaqësojnë një këshill me një apo katër fshatra atëherë prej në fshati nuk mund të marrin pjesë më shumë se dy persona e që mendoj se nuk është përfaqësim ashtu siç duhet. Sa i përket rendit të ditës unë pata një kërkesë që të marrë një mbështetje prej propozuesit dhe prej anëtarëve tjerë që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për shkak të rrethanave në të cilat gjendemi. Masat janë rënduar jo vetëm në nivel vendi por edhe Komunën e Podujevës, vala e pandemisë ka përfshirë dhe njëkohësisht e kemi numrin më të madh të personave të infektuar dhe të vdekurve, kështu nuk e di se si do të organizohen këto takime për arsye se po i bie që organi mos me i zbatuar detyrat e tij siç janë Inspektioni dhe institucionet tjera lokale dhe qendrore. Përbërja e komisionit do të jetë së paku prej 7 anëtarëve që do të marrin pjesë pa praninë e qytetarëve qoftë në qytet apo nëpër fshatra ku do të mbahen ato takime, është mirë të mendohet rreth këtyre tubimeve publike sepse së paku i takon edhe Kuvendit të merr një vendim lidhur me pikën në fjalë sepse ne në këtë takim të KPF-së po diskutojmë mirëpo Kuvendi merr vendim rreth kësaj pike. Ne jemi që të kalojmë kjo pikë e rendit të ditës por për shkak të rrethanave për formimin e komisioneve për anëtarët e Ekzekutivit dhe të Kuvendit në një tubim që kanë me qenë së paku 5 persona nga niveli komunal që do ta përcjellin punën andaj në këto rrethana është e pamundur që të organizohen

debate publike me qytetarë. Kërkoj nga drejtori i Drejtorisë së Administratës që nesër të konsultohet me Kryetarin e Komunës, t'i shqyrton rrethanat në të cilat gjendemi dhe para mbledhjes së Kuvendit nesër të arsyetohet shtyrjen e pikës që të mos hyjmë në debate të pa nevojshme.

**z.Fatmir Gashi Kryesues i Kuvendit**, theksoi, ne dëgjuam propozimin e anëtarit të KPF-së, z.Rafet Llapashtica që për shkak të kushteve dhe rrethanave në të cilat gjendemi i propozon drejtorit të Drejtorisë përkatëse, Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës, mendoj që drejtori dhe ne të gjithë duhet të jemi konstruktive dhe të shohim rrethanat dhe të marrim një vendim që do të jetë në të mirë të qytetarëve.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i DA, theksoi, sqarim për ju i nderuari koleg këshilltar, edhe një herë po mundohem ta sqarojë këtë propozim sepse nuk është fjala tani që të fillojmë me themelimin e këshillave të fshatrave ku do të mbledhen komisione dhe qytetarët e atyre lokaliteteve, fjala është diskutimi publik për rregulloren siç e kemi cekur edhe më herët që ne kemi menduar që kjo do të fillojë nga data 19.04.2021, pasi që të përfundoj faza e parë e këtyre masave që janë marrë sepse ne nuk e dimë se a do të vazhdojnë këto masa apo do të ndalojnë së zbatuari këto masa sepse është bërë një kohë e gjatë me këto masa që kanë ndikuar te të gjithë operatorë ekonomik që operojnë në Komunën e Podujevës por edhe në nivel vendi dhe që janë duke i dëmtuar ekonomikisht operatorët ekonomik, meqenëse ne nuk e dimë se deri kur do të vazhdojnë këto masa, ne vendosëm që diskutimi publik të fillojë nga data 19.04.2021 pasi që të përfundojë faza e parë që janë dy muaj, kohëzgjatje që unë kërkoja nga Ju që të marrë një lloj autorizimi Drejtoria e Administratës që t'i caktojë datat e debateve publike kurdo që krijohen kushte të tilla brenda kohëzgjatjes së diskutimit publik prej 2 muajve, gjithëherë konform masave anti Covid-19 në funksion të mbrojtjes së shëndetit publik. Nëse gjendja epidemiologjike vazhdon të jetë kështu ne mund të bisedojmë prapë për shtyrjen e kësaj rregulloreje por nuk mendoj se tani do të duhej të shtyhej meqenëse ka kohë të mjaftueshme prej datës 19.04.2021 deri më datë 18.06.2021, mundemi me japë kontributin në këtë drejtim përndryshe ne në asnjë mënyrë nuk jemi pro për të rrezikuar shëndetin e qytetarëve.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, mendoj se jemi të obliguar që të veprojmë në situatë rrethanash sepse nuk e dimë se situata epidemiologjike në të ardhmen a do të përmirësohet apo do të përkeqësohet, është e vërtetë se kur është shtyrë rregullorja më datë 09 shtator 2020, gjendja ka qenë më mirë. Unë e bëra propozimin dhe ky propozim është çështje e tyre, ne nuk guxojmë të mendojmë si institucion të organizojmë asnjë tubim mbi masat e lejuara. Kjo rregullore se si do të duket e përcaktojnë ligjet dhe udhëzimet se si do të jetë përbërja e fshatrave dhe numri i këshillave në bazë të numrit të këshillave dhe fshatrave.

Ne e kemi mbajtur një debat publik për këtë rregullore në restorant "Artela" në të cilin nuk ka marrë pjesë asnjë anëtarë qoftë nga Ekzekutivi apo Kuvendi, dhe i pranishëm isha vetëm unë në atë takim, pra s'ka dashur askush të japë kontribut rreth kësaj rregulloreje. Në atë takim ka qenë prezent Nënkryetari i Kuvendit të Komunës së Pejës sepse Komuna e Pejës është e para Komunë që i ka miratuar këshillat e fshatrave dhe se këtë rregullore e kanë në funksion qe dy vite, mirëpo prezent nuk ka qenë askush prej Komunës së Podujevës.

Ne kur diskutojmë, dikush është për e dikush kundër, sa i përket rregullores unë jam për dhe kisha dëshiruar që kjo rregullore të jetë në funksion por sa i përket rrethanave në të cilat jemi nuk mund të merr askush vendim sepse pastaj mund të penalizohet nëse në ato tubime parashihet numër më i madh i qytetarëve, si do që të jetë kjo mbetet përgjegjësi e propozuesit dhe e Kuvendit nesër se si do ta merr vendimin. Si do që të jetë propozimi, ne i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim, unë dëshirova me zgjatë pak debatin për shkak se në Kuvend numri i këshilltarëve është më i madh dhe ne po i shohim se si vendimet po i merr Kuvendi ashtu siç variojnë personat njerëzit por jo ashtu siç i analizojmë, për arsye se është e vërtetë se ne në Kuvend vijnë këshilltarë që votojnë dhe fuqizojnë vendimin por nuk e lexojnë fare materialin dhe nuk merren me situatën, e them këtë duke mos dashur ta nënçmoj askënd për punën e tij

për arsye se këshilltari/ja edhe kur është kundër apo për një propozim vendim nuk din të tregoi arsyen pse është, këtë desha me ngritë por si do që të jetë unë i rekomandoj kuvendit këtë propozim për shqyrtim.

**znj.Fatlume Jaha**, theksoi, unë mendoj për tej faktit që ta vërtetojmë pse jemi për dhe kundër, mendoj se këtu të gjithë e kemi një mendim të përbashkët që rrethanat kanë ndryshuar ashtu siç e ceku edhe drejtori përkatës, kështu që unë në përgjithësi nuk jam ithtarë e asaj që të hyjmë në situata të paqarta. Personalisht por edhe në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së, kisha kërkuar nga drejtori i Drejtorisë së Administratës që ta shqyrtojë mundësinë që të tërhiqet nga ky propozim ose ta sheh qartë modalitetin se si mund ta bëjë këtë. Unë prapë i qëndroj fjalës që në parim jemi për me kalu ky propozim, edhe pse me vonesë është marrë ky vendim por ndoshta ky propozim do të ishte dashur të sjellë pak më herët kur situata epidemiologjike ishte pak më e mirë ose të shtyhet sepse ne nuk mund ta dimë të paktën deri në dy muajt e parë të verës situatën epidemiologjike në vend, andaj ruajtja e shëndetit është primare.

Ne në të kaluarën kemi pas situata në të cilat janë anuluar edhe vendime shumë më të rëndësishme përballë shëndetit të qytetarëve, jemi në një situatë që nuk e dimë të ardhmen se çfarë masash do të ketë pas datës 18.04.2021, ndoshta mund ta dinë drejtori, por në këtë situatë më e mira ndoshta do të ishte që të mos marrim ndonjë vendim të paqartë. Ne si Kuvend, autorizimin që ju i nderuar drejtor e përmendët, a kemi mundësi t'ua japim kur kemi mundësi që të shtyjme këtë pikë për një seancë tjetër, t'ju them të drejtën ky më shumë është gjykim personal se sa i Grupit, por për hir të së mirës së përgjithshme unë mendoj se ne jemi në mes të dy zgjidhjeve, kur i thua diskutim publik kjo nënkupton se duhet ta pyesësh publikun e që në këto rrethana është e vështirë të realizohet ky proces, kështu që do të ishte mirë që për ndonjë seancë tjetër të shtyhet kjo pikë, përndryshe ne i qëndrojmë fjalës dhe i rekomandojmë këtë pikë për shqyrtim Kuvendit.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, unë nuk po dëshiroj me fut pikën e rendit të ditës në diskutim se kush është për e kush kundër, në mënyrë shumë të sigurtë dhe jo opozitare e dhashë mendimin tim si asamblist, atë që e ceku këshilltarja znj.Fatlume Jaha, jo ndoshta në emër të Grupit të këshilltarëve. Unë do ta japë mendimin tim edhe në Kuvend, jam për që kjo pikë të kalojë në Kuvend por mendimin tim të pavarur do ta japë sërish në Kuvend për arsye se dihen rrethanat në të cilat jemi, kam qenë për këtë propozim rregullore edhe herën e parë kur është sjellë si pikë e rendit të ditës nga Ekzekutivi i kaluar, jemi për edhe tani mirëpo askush nuk mund ta mbajë asnjë diskutim publik në rrethanat që jemi, përveç vetëm në mënyra individual e që do të ishte formë jo profesionale sepse ne si Kuvend me 35 asamblist/e nuk jemi jo profesional, dhe në këtë drejtim edhe Drejtorja do të dilte jo profesionale, andaj unë për çdo takim do të kërkoj procesverbalet për arsye se nëse shkojmë te këshilli i fshatrave, shembull, në fshatrat Obrancë, Bradash, Dobratin ku janë më shumë se 2000 banorë, e si Drejtori me mbajt takim me 3 persona dhe me u deklaruar pastaj se e kam kryer detyrën time, kjo është punë jo e kryer, dhe dikush do të del jo profesional apo që se ka kryer detyrën. Unë jam i interesuar që kur të bëhet debati publik të bëhet marketingu i duhur për të dalë në terren, me u ngritë komisioni, me ecë përpara dhe me i shqyrtuar dhe me i sensibilizuar qytetarët që kur të hyjë në funksion kjo rregullore për 4 vite do të jetë në funksion për këshillat e fshatrave dhe Ekzekutivi i ardhshëm pas muajit tetor 2021 që do të vijë do të punojë me ato këshilla dhe do të zhvillojë atë pjesë në bazë të rekomandimeve që ne japim.

Për shkak të rrethanave që jemi, sido që të jetë, nesër të merret vendim nga Kuvendi, por unë prapë qëndroj prapa pikës së rendit të ditës. Në Kuvend do ta ngrisë prapë këtë mendim, kjo të jetë çështje e Kuvendit dhe e secilit personalisht për rrethanat në të cilat jemi, nëse propozim rregullorja kalon, organizimin e tubimeve do ta përcjellë dhe shikoj me detaje. Propozimin tim mund ta vëni në votim apo jo, nuk është me rëndësi sa vota merr propozimi im në Kuvend por është përgjegjësi e jona nëse këtu flasim diçka tjetër e dikund diçka tjetër. Vendimi për masa anti covid-19 është vendim shtetëror që nuk guxojmë ta anashkalojmë sepse në qefte se ne nuk e zbatojmë si zyrtarë është përgjegjësi penale pastaj

nëse dikush infektohet me virusin, ky është shqetësimi im individual që e ngrita më parë si asamblist e jo qëndrim i Grupit të këshilltarëve nga radhët e PDK-së.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i DA, theksoi, edhe njëherë po e potencoj se nuk është kurrfarë ngutje që të futet për diskutim publik draft rregullorja në fjalë, edhe në fillim e thash se kërkoj edhe sugjerimet e juaja si Drejtori dhe t'i marrim ato sugjerime shumë seriozisht. Ne e dimë se në këtë situatë nuk mund të organizojmë diskutime publike por në të ardhmen ka mundësi që të krijohen kushtet, asnjëherë nuk do të mund të krijojmë apo të organizojmë diskutime publike në kundërshtim me masat e IKSHPK-së.

Sa i përket asaj që u cek për mbajtjen e takimeve publike me 2 ose 3 persona, unë zotohem këtu që Drejtorja e Administratës ka me i marrë të gjitha masat për propagandimin sa më të madh të diskutimeve publike, njoftime publike do të bëjmë gjithandej dhe në të gjitha format do të mundohemi me i sjellë qytetarët në diskutime publike por edhe në formimin e këshillave të fshatrave në datat e caktuara, mirëpo se a do të ketë pjesëmarrje ose jo kjo është çështje tjetër ngase dhunshëm nuk mund ta sjellim askënd në takimet publike. Para se të kërkon procesverbalet e çdo takimi mundohu me përcjellë pak formën propaganduese të njoftimit për këto diskutime publike, për këtë zotohem sepse është në kompetencën e Drejtorisë së Administratës dhe se propagandimi/njoftimi do të jetë në nivelin më të lartë të mundshëm

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, unë nuk dyshoj se ti drejtor nuk do të mundohesh që ta kryesh detyrën e juaj, por jam i bindur se në kohë pandemie nuk do të përgjigjet askush, pa keqkuptime, këtu nuk po diskutojmë pozitë/opozitë sepse ju e dini qëndrimin tim. Qëllimi është se nëse ju si Drejtori e ftoni dikë në takim në sallë me 40 persona dhe s'të përgjigjet askush, ti në fillim e dinë se takimi dështon dhe në fillim dihet se detyra nuk përfundon ashtu siç duhet. Takimet mund të mbahen edhe me dy persona por ju si Drejtori nuk keni të drejtë të bëni thirrje për takime publike sepse drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit bie në dilemë për këto takime. Po e citoj këngëtarin Afrim Muçiqi i cila ka thënë se lejohen organizimet e dasmave me 10 persona kurse organizimet e tubimeve në fushatë elektorale me nga 200 persona e që s'ju ka interesuar shqiptimi i dënimeve sepse secili subjekt/parti politike ka paguar dënimet me nga 2000€, por përgjegjësia njerëzore s'ka mbetur askund, kurse për qytetarët ka mbetur çështje tjetër, por është çështje tjetër kjo. Obligimi ynë si këshilltarë është me krye detyrën tonë, ndërsa kush ta jep të drejtën ty si drejtor të thirrni tubime, meqë po thoni qytetarët vijnë ose s'vijnë.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i DA, përgjigje parafoletit, theksoi, e diskutuam këtë çështje disa herë, ne nuk e kemi ndërmend me thirr tubime publike para se të krijohen kushtet.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, a më tregoni qysh merr vendim niveli komunal për një tubim publik me banorët e fshatit Kërpinëh, shembull, kur tubimet janë të ndaluara në mënyrë strikte, ku si Drejtori as thirrje publike nuk guxon të bëni, këtu është problemi, por si do që të jetë Kuvendi e merr vendimin sepse unë këtu jam për ta lehtësuar punën dhe për ta shty procesin përpara sepse kur dua ta shtyjë një proces përpara nuk dua të kthej tre hapa prapa tani.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, dëgjuam propozimet e shumicës me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet që u dhanë nga anëtarët e KPF-së dhe të drejtorit të Drejtorisë përkatëse që t'i rekomandojmë këtë pikë të rendit të ditës Kuvendit për shqyrtim.

**znj.Fatlume Jaha**, theksoi, poenta ishte që ne t'i jap një autorizim drejtorit të Drejtorisë së Administratës që kur të krijohen rrethanat pastaj ai të organizojë debatet publike, por unë prapë kam një kërkesë për Ekzekutivin që ta shqyrtojë mundësinë më të mirë sepse ne nuk e di sa jemi të thirrur të japim një lloj para-autorizimi kur ne e dimë që ndodhet një mjegull para nesh dhe ne nuk mund të gjykojmë se çka ka prapa mjegullës, dhe më mirë është që pasi të kalojë mjegulla pastaj të kemi pamje të qartë se çfarë ka para nesh, prandaj besoj se drejtori do ta shqyrtoj edhe një herë këtë mundësi, do t'i marrë parasysh shqetësimet që ishin të përbashkëta, duhet të jemi real sepse edhe vet ai shfaq shqetësime dhe shpresoj se do të vie me një vendim shumë më konkret seancën e radhës.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, ne këtu kemi prezent Nënkrjetaren e Komunës që përfaqëson Ekzekutivin, dhe kemi prezent edhe drejtorët. Edhe pse për momentin të gjithë i shprehen shqetësimet e veta dhe sigurisht se Nënkrjetarja e Komunës do t'i përcjellë këto shqetësime të ngritura sot në këtë mbledhje të KPF-së, që kërkohet që shqyrtohen dhe vlerësohet situata dhe rrethanat aktuale që në seancën e nesërme të Kuvendit të vihet me një propozim sa më konkret dhe më të qëndrueshëm në aspektin e mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve nga kjo e keqe që po na përcjellë.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, drejtori i DA kërkoj një autorizim nga Kuvendi që në këto rrethana shëndetësore të organizoj debate publike, në këto rrethana një asamblist i ndërgjegjshëm ose të paktën po them unë nesër në mbledhjen e Kuvendit do të jem kundër që në këto rrethana të bëhet thirrja publike për debate publike sepse është vendimi i Qeverisë dhe jemi në gjendje të rënduar. Ministria e Shëndetësisë mbrëmë ka bërë njoftim se po që se ndodhin edhe dy raste nuk mund të japë trajtim mjekësor, e mos të flasim për gjendjen shëndetësore në Komunën e Podujevës, ndoshta asgjë nuk ndodh por si do që të jetë ne nuk mund ta kryejmë punën tonë sepse pas andej edhe prej subjekteve politike do të bëhet një komision. Unë e bëra një propozim por nuk desha që të hidhet në votim sepse përgjegjësia më e madhe është e drejtorit, se sa e imja, unë e ngrita në mënyrën time propozimin tim se çka kisha propozuar, e jo se çfarë dëshiron të punojë ai me kokën time, por duhet të punohet me ligj dhe në bazë të rrethanave që jemi. Po e shohë që disa herë si Ekzekutivi edhe në të kaluarën edhe tani e shoh si dështim të tërhiqet për diçka për të cilën kërkohet të kalohet, këtu është pengesa e demokracisë dhe jemi liberal, që thotë e kam sjellë por vendimi është marrë mbrëmë në Qeveri dhe i nderuari Kryesues i Kuvendit unë jam për me tërheqë këtë pikë të rendit të ditës, nëse dëshironi ju, dërgojeni këtë pikë të rendit të ditës në Kuvend. Këtu është problemi i një njeriu që udhëheq diçka e nuk është problemi pse unë si Rafet propozoj diçka e që duhet në çdo formë të kaloj se ndoshta në KPF dikush voton që mos të kalojë kjo pikë e rendit të ditës.

**z.Patriot Rudari**, theksoi, propozimi ishte që pas datës 19.04.2021 të filloj diskutimi publik nëse lehtësohen masat e ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, ne nuk e dimë se çfarë masash do të merren në të ardhmen sepse nuk e kemi ditë as për këto masa që janë marrë nga sot dhe as masat e javës së kaluar të Qeverisë së Republikës së Kosovës për mbyllje të vendit, ju lutem koleg i nderuar zotëri Patriot ju jeni me profesion profesor dhe në vend që ta udhëzoni dikë, dhe ju mbështetje politike nuk mund ti jepni askujt para meje kur gjendja është ashtu, andaj nuk dëshiroj t'ju drejtohem kështu sepse nuk e dimë në të ardhmen se çfarë do të ndodhë.

Në stres kemi qenë e gjithë Komuna e Podujevës kur është shfaq rasti i parë i personit të infektuar me virusin Covid-19, dhe ju e dini sepse keni qenë asamblist ku kemi ndarë mjete buxhetore dhe të gjithë jemi izoluar kur e kemi pasë vetëm një person të infektuar në fshatin Dumnicë, Komuna e Podujevës e tëra në këmbë është ngritë, kurse tani e dimë cila është gjendja dhe sa persona janë të infektuar në Komunën e Podujevës, andaj unë nesër nga drejtori i DSHMS do të kërkoj të dhënat për gjendjen shëndetësore në Komunën e Podujevës për të gjithë ata pacientë të infektuar me virusin Covid-19, dhe cila është gjendja e tyre dhe sa pacient janë në trajtim të rëndë në QKUK, dhe sa është numri i pacientëve të vdekur, kur dihet se ditën e djeshme ka vdekur një person i infektuar nga virusi Covid-19. Sa i përket anës time, jo tubime publike por 300 ose 500 persona në një sallë futni.

Çështja tjetër, kur dikush diskuton, të mos thotë askush se nuk po diskutohet në mënyrë publike dhe politike, po bënë sjellje opozitare, sepse nuk është sjellje e tillë. Kur Gjermania dhe Britania e madhe janë mbyllë, në këtë aspekt Kosova s'ka çka diskuton sepse ne nuk mund të jemi më të mençur këtu se një dynja, prandaj këtu është problemi por sido që të jetë zotëri Kryesues, kalo në pikën tjetër sepse këtu nuk kemi më pse dhe çka të diskutojmë.

**znj.Fatlume Jaha**, theksoi, këtu kemi tri situata, e para që ta rekomandojmë materialin për Kuvend ashtu si ka ardhë, e dyta me propozimet e drejtorit që për të cilat ne nuk u pajtuam sepse ne nuk pranojmë të hyjmë në një situatë kur nuk e dimë se çfarë do të ndodhë pas datës 18.04.2021, por të paktën unë marrë të

drejtën të parashikojë se çfarë vendimesh do të marrë Qeveria dhe nuk mund ta autorizojë drejtorin që të veprojë varësisht prej rrethanave sepse ne mund ta mbajmë një seancë nëse është e domosdoshme me këtë pikë të rendit të ditës dhe atëherë ia japim autorizimin në varësi të rrethanave me të cilat ndodhemi ose është edhe opsioni i tretë të cilin e propozoj z.Rafet Llapashtica që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës.

Ne nuk jemi për atë që të japim një vendim varësisht rrethanave kur mund ta thërrasim një seancë tjetër kështu që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës ose t'i rekomandohet Kuvend për shqyrtim dhe pastaj Kuvendi të vendosë se si do të ecim tutje, ndoshta edhe drejtori mund të reflektojë deri në një seancë tjetër të radhës. Ky është qëndrimi i qartë që vetëm na tregon se cilat mundësi i kemi që t'i hedhim në votim dhe ne pastaj ne kemi qëndrimet tona siç i deklarova.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, ne këtu jemi përballë këtyre situatave ku sipas propozimit të drejtorit të Drejtorisë përkatëse është sipas materialit që e kemi marrë me kohë që kjo pikë e rendit të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, mirëpo kemi edhe kërkesën tjetër që kjo pikë të tërhiqet nga rendi i ditës dhe të sjellët në një situatë tjetër më të favorshme varësisht rrethanave të krijuara nga gjendja epidemiologjike.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, pasi që ka ardhë materiali dhe janë marrë vendimet strikte është dashur menjëherë zyrës ligjore me ia përcjellë materialin, me mirëkuptimin ose nesër në Kuvend që kjo pikë të hidhet poshtë. I nderuar Kryesues, nëse në muajt korrik dhe qershor mbahen tubimet publike ashtu siç e ceku drejtori i DA, duhet me u mësu njëherë dikush që e merr timonin dhe ecë përpara, në qoftë se në korrik ose gusht mbahen këto tubimet që do të mbahen për 20 këshillat e fshatrave dhe të gjitha lagjet e qytetit pastaj do të zgjedhet edhe komisioni për këtë çështje, po flasë në bazë të materialit zyrtar që ka ardhë nga administrata komunale, andaj shtrohet pyetja se kush i kryen ato organizime të tubimeve publike sepse nuk mund të deklarohesh dhe pastaj ndoshta tubimet publike do të mbahen më vonë. Vendimi kur të merret kërkon sqarim për mua personalisht. Unë nuk dua të merrem me punën e asnjë këshilltari që mos t'i bëhet askujt presion për të mos votuar, po e lëmë 2 apo 3 muaj propozimin në debat publik. Ne mundemi me marrë vendim dhe me hedhë pas shpine dhe pastaj me dalë me bë një njoftim për media, edhe këtë mund ta bëjmë, asgjë s'na pengon ne.

**znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës**, theksoi, mendimet e secilit i kemi parasysh dhe është mirë që të shkojmë në votim, dhe pastaj realisht vendos shumica se si do të vazhdojmë më tutje.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, lidhur me atë që Nënkryetarja e potencoj, i të njëjtit mendim jam edhe unë dhe e respektoj vendimin e shumicës.

**z.Fatmir Gashi Kryesues i Kuvendit**, theksoi, ne me planin e punës muajin gusht e kemi të paraparë muaj pushimi, andaj çfarëdo që keni, duhet ta kemi parasysh këtë, vetëm për ndonjë rast eventual të jashtëzakonshëm mund të thirret mbledhja e Kuvendit.

**znj.Adelina Stublla**, theksoi, unë si asambliste dhe si punëtore shëndetësore mendoj se kjo pikë e rendit të ditës duhet të shtyhet në një afat të pa caktuar për shkak të gjendjes së shkaktuar nga pandemia Covid-19, dhe masave të marra nga Qeveria. Duke marrë parasysh masat dhe rrethanat e të vdekurve dhe të infektuarave unë mendoj se këto debate publike dhe kjo pikë e rendit të ditës të shtyhen në një afat të pacaktuar.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, në mbledhjen e Kuvendit në mënyrë shumë njerëzore do ta marrë fjalën dhe do të kërkojë mirëkuptimin e drejtorit të DA-së për ta tërheqë këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Mehmet Gashi**, theksoi, unë mendoj se propozimi i znj.Adelina Stublla ishte shumë i qartë se për shkak të rrethanave të shtyhet kjo pikë dhe në momentin kur të krijohen rrethanat ne mund ta thërrasim një mbledhje edhe nëse është mbledhje e jashtëzakonshme dhe ta përfundojmë këtë çështje, andaj mos ta zgjasim më shumë sepse nuk janë rrethanat e mira. Ne e përkrahim propozimin e znj.Adelina Stublla.

**z.Florent Hasani**, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së pas ngritjes së gjitha këtyre shqetësimeve mendojmë se kjo pikë e rendit të ditës duhet të shtyhet për një kohë të pacaktuar.



E ndërrojmë qëndrimin për arsye të argumenteve të paraqitura.

**z.Fatmir Gashi Kryesues i Kuvendit**, theksoi, arsyeja e shtyrje së kësaj pike të rendit të ditës veç po dihet nga të gjithë, sigurisht drejtori i DA-së dhe Ekzekutivi i Komunës kur e kanë paraparë këtë pikë të rendit të ditës nuk i kanë paraparë marrjen e këtyre masave shtesë nga Qeveria, dhe një gjendje të tillë ku epidemia është përhapë me përmasa të mëdha në të gjitha grup moshat me variante të reja të virusit Covid-19, andaj këtë propozim e hedh në votim me konstatim se për shkak të rrethanave të krijuara nga gjendja epidemiologjike, kjo pikë e rendit të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për shtyrje për një afat të pacaktuar.

*Njëzëri i rekomandohet Kuvendit që Propozim vendimi për vënie në diskutim publik të propozim Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës të shtyhet për një afat të pacaktuar kohorë varësisht rrethanave të krijuara nga gjendja epidemiologjike në vend.*

#### **4. Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Batllavë – Propozimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues**

**znj.Bahrije Shatrolli Mehmeti**, drejtoresh e DPKGJ, theksoi, propozim vendimin e kemi bazuar në ligjin nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Nëse më lejohet, unë detaisht do të doja t'i prezantoj të gjitha propozim vendimet për dhënie në shfrytëzim. Në propozim vendimin paraprak kemi këto njësi kadastrale, dhe atë, -parcela nr.389/1 zona kadastrale Podujevë në të cilën është ndërtuar lokali afarist në sipërfaqe prej 16m<sup>2</sup>, në rrugën "Skenderbeu";

-parcela nr.2858/0 zona kadastrale Podujevë, lokali afarist në sipërfaqe prej 76.95 m<sup>2</sup>;

-parcela nr.495/4 zona kadastrale Lupç i Poshtëm me sipërfaqe 2ha e 3403 m<sup>2</sup>, vendi i quajtur "Bugurdoll"; -parcela nr.209/0 zona kadastrale Lupç i Poshtëm me sipërfaqe 3ha e 8882 m<sup>2</sup>, vendi i quajtur "Bugurdoll", dhe

-parcela nr.2159/0 zona kadastrale Batllavë në sipërfaqe 2ha e 4884 m<sup>2</sup>, vendi i quajtur "Zllatushë".

Të nderuar, këto janë propozim vendimet për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale për të cilat të gjitha detajet dhe specifikat tjera mund t'i gjeni në dokumentet përkatëse që u janë dërguar me thirrjen e mbledhjes, mirëpo nëse dëshironi ndonjë sqarim apo pyetje shtesë, urdhëroni jam në dispozicion t'ju përgjigjem.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, nga drejtoresha parafolëse e DPKGJ u bë prezantimi për të gjitha propozim vendimet për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim për të gjitha pronat që parashihen të jepen në shfrytëzim, andaj materialet për të gjitha (5 propozim vendime) i keni dhe keni mund t'i analizoni. Prandaj nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni.

**z.Mehmet Gashi**, theksoi, në parim ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së, i mbështesim këto pika të rendit të ditës të cilat të bazuara në ligj dhe rregulla të punës. Konsiderojmë se më mirë është që këto prona të jepen në shfrytëzim dhe të ketë inkasim të të hyrave se sa të shndërrohen në deponi të mbeturinave. Propozoj që komisionet përkatëse të ngriten në mbledhjen e Kuvendit dhe në bazë të përfaqësimit në Kuvend por edhe sipas dispozitave ligjore të caktohen anëtarët e komisioneve në fjalë, kështu që ne, në parim i përkrahim pikat e propozuara që janë për dhënien e pronës në shfrytëzim.

**z.Florent Hasani**, theksoi, grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së, në parim e mbështesim këtë pikë por kam një pyetje se a ka mundësi që të gjitha këto pika të rendit të ditës të futen në një pikë sepse në të

kaluarën kemi pas shumë prona në një pikë të vetme dhe këtu e shohim se secila është e shpërndarë veç e veç andaj kërkoj një sqarim nga ana e drejtoreshës së DPKGJ.

**znj. Bahrije Shatrolli Mehmeti**, drejtoresh e DPKGJ, theksoi, lidhur me komisionet për dhënie në shfrytëzim, praktikat e më hershme por edhe rregullimi në aspektin ligjor kanë qenë që me një vendim të ngritën komisioni në fjalë dhe atë me mandat të Kuvendit dhe për të gjitha proceduar e dhënies në shfrytëzim, mirëpo në vitin 2020 me ndryshimin e Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, parashihet që pas çdo vendimi të miratuar në Kuvend duhet të ngrityet për të njëjtin edhe komisioni për zhvillimin e proceduarave.

**z. Florent Hasani**, pyetje, theksoi, anëtarët e komisionit a duhet të jenë të njëjtë apo secili komision duhet t'i ketë anëtarët e ndryshëm.

**znj. Bahrije Shatrolli Mehmeti**, drejtoresh DPKGJ, përgjigje parafolësit, theksoi, për secilin vendim të miratuar duhet të jetë një komision i veçantë.

**z. Rafet Llapashtica**, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së, i rekomandojmë për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit pikat e paraqitura nga drejtoresha e DPKGJ.

**z. Fatmir Gashi Kryesues i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim, kush është për që t'i rekomandohen Kuvendit për shqyrtim pikat / propozim vendimet përkatëse të paraqitura nga drejtoresha e DPKGJ.

*Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim (në pako) Propozim vendimet për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së Komunës - Propozimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues prej pikës së 4 deri në pikën e 8, dhe atë si në vijim:*

**4. Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Batllavë – Propozimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues**

**5. Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Lupç i Poshtëm – Propozimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues**

**6. Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Lupç i Poshtëm – Propozimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues**

**7. Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Lokal në qytetin e Podujevës – Propozimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues**

**8. Propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Lokal në qytetin e Podujevës – Propozimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues**

## **9. Propozim vendimi për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës**

**z. Mehmet Gashi**, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim këtë pikë të rendit të ditës mirëpo duhet të merren parasysh propozimet e anëtarëve të komisionit dhe përbërjes së Kuvendit sa i përket propozimeve të anëtarëve të komisionit.

**z. Florent Hasani**, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e LVV-së i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim këtë pikë të rendit të ditës.

**z. Rafet Llapashtica**, theksoi, edhe ne këshilltarët nga Grupi i PDK-së i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim këtë pikë të rendit të ditës.

**z. Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, nëse dikush tjetër nga anëtarët e Kuvendit ka diçka për të shtuar, urdhëroni, nëse jo atëherë e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës.

*Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim Propozim vendimi për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës*

#### **10. Informatë e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit**

**znj.Elhame Kutllovc**, drejtoreshë DKRS, theksoi, duke u bazuar në planin e punës të Kuvendit Komunal të vitit 2021 është paraparë një informatë nga DKRS, materialin e keni përpara kështu që nëse dikush ka ndonjë pyetje atëherë lirshëm mund të paraqitni.

**znj.Arlinda Kadriu**, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së i rekomandojmë Kuvendit për diskutim këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Florent Hasani**, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së i rekomandojmë Kuvendit për diskutim këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Rafet Llapashtica** theksoi, ne grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së i rekomandojmë Kuvendit për diskutim këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, nëse dikush tjetër nga anëtarët e Kuvendit ka diçka për të shtuar urdhëroni nëse jo atëherë e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës

*Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim Informata e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit*

*Kryesuesi i Komitetit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.*

**Mbledhja përfundoi në orën 11:00**

**Procesverbalin e mbajti**

**Enis Sheholli**

**Nr.01-060/04-0030562/21**

**Podujevë,**

**06 prill 2021**

**Kryesuesi i Komitetit**

**Fatmir Gashi**